

V E N D I M
Nr.509, datë 13.8.1998

**PËR KALIM KAPITAL TË DISA OBJEKTEVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
TË REZERVAVE TË SHTETIT NËN ADMINISTRIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 3.4.1993 "Për kalimin e objekteve dhe të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe të institucioneve shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit të bëjë kalim kapital pa pagesë, të objekteve dhe të mjeteve kryesore, sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi, nën administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes, për përqendrimin e municioneve në depo të mëdha dhe jashtë qendrave të banuara.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E OBJEKTEVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË SHTETIT QË ME KALIM KAPITAL KALOJNË NËN ADMINISTRIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES

1. Objekti Mollëz
2. Objekti Mezhgoran
3. Objekti Vërtop
4. Objekti Kakrrugë

Mat
Gjirokastër
Berat
Skrapar